



International
Labour
Organization

Projekti për “Adresimin në Nivel Lokal të Sfidës së Punësimit të të Rinjve në Shqipëri”

Thirrje për propozime

KONKURS PËR IDE NË LIDHJE ME BIZNESIN E VOGËL

Në vitin 2008, Universiteti i Tiranës hapi një degë të saj në Kukës. Në verën e vitit 2011, u bë diplomimi i kursit të parë nga Fakulteti Ekonomik. Pavarësisht njohurive të tyre në lidhje me Rajonin dhe marrjes së parimeve teorike në lidhje me biznesin, vetëm disa prej tyre e shohin sipërmarrjen si një alternativë. Projekti për Adresimin në Nivel Lokal të Sfidës së Punësimit të të Rinjve, i financuar nga SDC dhe në bashkëpunim me Agjensinë Shqiptare për Investim dhe Zhvillim (ASHIZH) e ka mbështetur promovimin e sipërmarrjes si një burim punësimi dhe gjenerimi të ardhurash. Në muajin tetor të vitit 2013 u bë hapja e një konkursi mbarkombëtar, i cili mblodhi mbi 180 aplikime nga i gjithë vendi. Tani, projekti ka ndërmend të aplikojë të njëjtin koncept në rajonin e Kukësit, duke promovuar një konkurs për ide biznesi, i cili mund të nxisë shpirtin e sipërmarrjes tek të rinjtë dhe të promovojë ndërmarrje/biznese të reja, dhe si rrjedhojë vende të reja pune.

Kush mund të konkurojë:

- Konkurentët mund të marrin pjesë në mënyrë individuale ose me ekipe/grupe për të krijuar modele biznesi të orientuara drejt rritjes ekonomike;
- Pjesëmarrësit duhet të jenë deri në moshën 29 vjeçare, si meshkuj ashtu edhe femra dhe duhet të jenë banorë në rajonin e Kukësit (të paktën një vit pas datës së mbylljes së këtij konkursi);
- Pjesëmarrësit të cilët konkurojnë si individë duhet të jenë ose të kenë qenë studentë në Fakultetin Ekonomik në Kukës; Në rast pjesëmarrje në grup/ekip të paktën drejtuesi i grupit duhet të jetë ose të ketë qenë student në Fakultetin Ekonomik në Kukës;
- Propozimi i biznesit duhet të jetë puna dhe idetë origjinale të vetë ekipit/grupit. Disa tema për bizneset e reja që mund të mendohen dhe të merren parasysh nga ofruesi mund të jenë: Krijimi i një brandi/marke për produktet tradicionale të rajonit të Kukësit; Fermat e Agro-turizmit; Marketingu/reklamimi ndërkufitar i produkteve të rajonit të Kukësit, etj.
- Prezantimi i një plani të plotë biznesi jo më vonë se data 30 prill 2014.

Çmimet

Fituesit e dy vendeve të para të konkursit- ato të cilët përfaqësojnë mundësinë më të mirë për rritje të mëtejshme dhe për thithje të financimeve nga jashtë- do të marrin një çmim në para prej 5,000 USD secili. Konkursi shpërblen mendimin krijues në lidhje me tregjet, produktet dhe shërbimet e reja, si edhe strategjinë e ekipit për të zbatuar planet e tij. Çmimi në para ofrohet me qëllim nxitjen e miratimit dhe vënien në zbatim të planit. Çmimi në para për fituesit do të transferohet menjëherë pas regjistrimit të kompanive të reja.

Gjykimi

Një panel përzgjedhës i cili përbëhet nga një përfaqësues nga projekti, një përfaqësues nga Fakulteti Ekonomik në Kukës si edhe një përfaqësues nga Këshilli Rajonal i Kukësit do të bëjë vlerësimin e planeve të biznesit të paraqitura duke ndjekur kriteret e mëposhtme:

- Inovacioni
- Tregu
- Ekonomia e biznesit
- Veprimet
- Ekipi drejtues
- Financimi

Proçedurat e përzgjedhjes do të përfundojnë brenda fundit të muajit maj 2014. Regjistrimi i ndërmarrjeve të reja do të përfundojë brenda fundit të muajit qershor 2014.

Nëse i plotësoni kërkesat e mësipërme dhe dëshironi të konkuroni për projektin e lartpërmendur, jeni të lutur të paraqisni Shprehjen tuaj të Interesit, Planin e plotë të Biznesit së bashku me CV-në/të tuaja si edhe çertifikatën e vendbanimit, **brenda datës 30 prill, 2014 në orën 12:00 në mesditë**, në adresën e mëposhtme.

Ju lutemi të shkruani *“Konkurs për Ide për Biznesin e Vogël”* tek subjekti në emailin tuaj.

Z. Bukurosh Onuzi

Koordinator Rajonal për Kukësin

Adresa: Këshilli Rajonal i Kukësit

E-mail: buabon@yahoo.com

Cel: +355 692096645